

Disa këshilla se si të flisni me fëmijët për #Koronavirusin

1. Të jeni të qetë dhe të informuar dhe t'i thoni gjërat ashtu siç janë.
2. Përshtateni mënyrën e komunikimit sipas moshës së fëmijës tuaj - merr parasysh nëse më shumë informacion e bën fëmijën më shumë apo më pak të tensionuar.
3. Tregojani faktet në mënyrë të thjeshtë dhe me qetësi – fëmija ndikohet nga mënyra e sjelljes tuaj.
4. Pyeteni fëmijën se çfarë di, përgjigjuni pyetjeve së tij/saj dhe sqaroni çdo keqinformim.
5. Vlerësojini ndjenjat e tij/saj ndërkohë që i/e siguron se “E dini se kjo gjë është e frikshme, por rreziku është i ulët dhe ne jemi të përgatitur mirë”.
6. Bëjani të qartë se çfarë është në dorën e tij/saj: të lajë duart mirë dhe shpesh, kur kollitet ose teshtin ta mbulojnë gojën me bërryl dhe të flejë mjaftueshëm.
7. Bëhuni model për përdorimin e një higjene të mirë dhe mundohuni të bëheni argëtues! Shoqërojeni larjen e duarve me ndonjë këngë, ndërsa fërkoni duart për së paku 20 sekonda!

